



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 28/2 DATË 20.11.2017

PËR PLOTËSIM TË MËTEJSHËM DOKUMENTACIONI LIDHUR ME KËRKESËN PËR PËRFITIM TË STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “KOMPLEKS TURISTIK DHËRMI”

Në mbështetje të Nenit 9 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë” dhe Kreut II, pika 8 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015, Komiteti i Investimeve Strategjike,

VENDOSI:

1. Plotësim i mëtejshëm me dokumentacion shtesë mbi kërkesën për përfshirjen e projektit investues “Kompleks Turistik Dhërmi”, me subjekt aplikues “STARTEK sh.p.k.” NUIS/NIPT: L22327007K në procedurën “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar”, pasi projekti vlerësohet ende i pamaturuar.
2. Subjekti propozues duhet të plotësojë dosjen e projektit me dokumentacion mbi identifikimin e qartë të zonës së synuar për zhvillim në ZK Nr. 1481 dhe me kontratat e lidhura ndërmjet pronarëve dhe subjektit propozues së projektit “Kompleks Turistik Dhërmi”.
3. Projekti “Kompleks Turistik Dhërmi” duhet të jetë në përputhje me termat teknike të PPV Bashkia Himarë.
4. Subjekti propozues duhet të paraqesë garanci financiare shtesë për realizimin e projektit të synuar.
5. Plotësim i mëtejshëm me dokumentacion shtesë sipas pikave të lart përmendura të realizohet nga subjekti propozues brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Afati 30 ditor vendoset duke marrë parasysh kohën që nevojitet për të lidhur marrëveshjet me pronarët.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

SENIDA MESI